



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËS FRËNGE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Historia e Francës

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; 20 leksione, 20 seminare

Viti / Semestri : Viti II, semestri II

Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme

Programi i studimit: “Bachelor në Gjuhë Frënge”

Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore:

Historia e Francës synon t’u paraqesë studentëve, përmes një kuadri kronologjik, një sintezë të ngjarjeve që shenjuan Historinë e Francës që nga Antikiteti deri te Franca aktuale. Kjo panoramë e plotë e Historisë së Francës, që nga origjina e deri te Republika V, pasurohet edhe me elementë të civilizimit dhe kulturës duke ofruar kështu aspekte të kronikës, të jetës së përditshme dhe të jetës sociale, por edhe historinë e njerëzve (njerëz të shquar : mbretër, mbretëresha, por edhe përfaqësues të vegjëlisë), si dhe rrymat e mëdha ekonomike, sociale e artistike që shoqëruan historinë e popullit francez.

Objektivat specifike lëndore:

Ky kurs synon jo vetëm t’u ofrojë studentëve një informacion të pasur lidhur me faktet më të spikatura të Historisë së Francës, por edhe t’i pajisë ata me metodologjinë dhe qasjet e duhura që t’i aftësojnë:

- të argumentojnë me frymë kritike mbi një fakt historik
- të identifikojnë dhe përzgjedhin burime të ndryshme historike për të përgatitur një temë të caktuar.
- të identifikojnë shkaqet dhe pretekstet që prodhojnë ngjarje të mëdha historike
- t’i vendosin ngjarjet në procese historike afatgjata në një perspektivë krahasuese.
- të përzgjedhin midis optikave dhe këndvështrimeve të ndryshme të historisë, të pozicionohen e madje të formulojnë edhe ata vetë opinionet dhe konsideratat e tyre mbi ngjarje dhe momente të rëndësishme të Historisë.